



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

Nr.80 , date 16.04.2010

PËR ORGANIZIMIN E MBLEDHJES SË PROKURORËVE

Me synimin, për të siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e punës në prokuroritë e rretheve dhe të apelit dhe për të rregulluar komunikimin me Prokurorinë e Përgjithshme në rastet e problematikave të hasura gjatë aktivitetit të tyre

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 germa "gj" e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ":

URDHËROJ:

1. Në funksion të drejtimit dhe organizimit të punës drejtuesit e prokurorive do të organizojnë, të paktën dy herë në muaj, mbledhjet e e prokurorëve për të diskutuar temat që kanë të bëjnë me funksionimin më të mirë dhe kryerjen e detyrës brenda secilës prokurori.
2. Në këto mbledhje, në varësi të temave që mund të trajtohen, do të mund të thirren përveç prokurorëve, edhe oficerët e policisë gjyqësore, të cilët do të kenë të drejtën e fjalës, por jo të votës. Thirrja e mbledhjeve do të bëhet me një paralajmërim të mjaftueshëm dhe në të do të përfshihet një listë e çështjeve që do të trajtohen, duke qenë e detyrueshme pjesëmarrja në mbledhje, përjashto arsyet e përligjura.
3. Përveç temave të mbledhjes të zgjedhura nga drejtuesi, çdo prokuror apo oficer i policisë gjyqësore mund të kërkojë diskutimin e problemeve të lindura

gjatë veprimtarisë profesionale, gjë që mund të kërkohej paraprakisht ose gjatë zhvillimit të mbledhjes. Këto tema bëhen menjëherë pjesë e rendit të ditës. Në se ekzistojnë rrethana objektive që nuk lejojnë shqyrtimin e tyre në të njëjtën mbledhje, drejtuesi i prokurorisë mund të shtyjë diskutimin e tyre jo më larg se në mbledhjen pasardhëse.

4. Mbledhja drejtohet nga drejtuesi i prokurorisë ose nga një prej zëvendësve të autorizuar prej tij në rast të mungesës apo pamundësisë për të marrë pjesë në mbledhje. Në rastin kur drejtuesi çmon se problemet e diskutuara i duhen referuar për zgjidhje Prokurorit të Përgjithshëm, përgatitet një raport përmbledhës i cili, i shoqëruar dhe nga procesverbali i mbledhjes, i drejtohet këtij të fundit. Sa më sipër mund të bëhet edhe me kërkesë të çdo prokurori pjesëmarrës në mbledhje, kur për miratimin e saj voton më tepër se gjysma e prokurorëve pjesëmarrës. Raporti përmbledhës, i cili përpilohet nga drejtuesi i prokurorisë, miratohet në mbledhjen pasardhëse, përveç rastit kur urgjenca mund të kërkojë dërgimin e tij menjëherë.

5. Në çdo mbledhje, sipas rastit, do të mbahet në mënyrë të përmbledhur një procesverbal i shkruar ose do të bëhet një regjistrim audio. Detyra e mbajtjes së procesverbalit apo e regjistrimit audio do t'i ngarkohet nga drejtuesi një sekretareje me formim juridik. Në çdo rast, në procesverbal ose në regjistrimin audio duhet të pasqyrohen emrat e prokurorëve apo oficerëve të policisë gjyqësore që nuk janë të pranishëm. Procesverbalet e mbledhjeve dhe regjistrimet audio ruhen në arkivin e prokurorisë.

6. Konsultimet që prokuroritë do t'i kërkojnë Prokurorisë së Përgjithshme, do të marrin zgjidhje, kur kjo kërkohej, në një afat sa më të shkurtër, me ndërhyrjen, kur është rasti të Këshillit të Prokurorisë. Në rastet kur problemi i parashtruar për zgjidhje ka një rëndësi të veçantë, qëndrimi i Prokurorisë së Përgjithshme i dërgohet të gjitha prokurorive.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Ina RAMA